L I G J
Nr. 8815, datë 20.9.2001

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS ITALIANE, LIDHUR ME VEPRIMTARINË E BASHKËPUNIMIT DHE TË ASISTENCËS PËR RISTRUKTURIMIN E INFRASTRUKTURAVE LOGJISTIKE DHE STËRVITORE NË AKADEMINË E FORCAVE AJRORE NË VLORË DHE PËR RISISTEMIMIN E PISTËS SË FLUTURIMIT PREJ DHEU NË PISHË - PORO"

Në mbështetje të neneve 12 pika 3, 78, 81, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës Italiane, lidhur me aktivitetin e bashkëpunimit dhe asistencës për ristrukturimin e infrastrukturave logjistike dhe stërvitore në Akademinë e Forcave Ajrore në Vlorë dhe për risistemimin e pistës së fluturimit prej dheu në Pish Poro", nënshkruar në Tiranë, më datë 7 qershor 2001.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3092, datë 22.9.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJE
MIDIS MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS ITALIANE, LIDHUR ME VEPRIMTARINË E BASHKËPUNIMIT DHE TË ASISTENCËS PËR RISTRUKTURIMIN E INFRASTRUKTURAVE LOGJISTIKE DHE STËRVITORE NË AKADEMINË E FORCAVE AJRORE NË VLORË DHE PËR RISISTEMIMIN E PISTËS SË FLUTURIMIT PREJ DHEU NË PISHË-PORO

Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Mbrojtjes e Republikës Italiane, të quajtura në vazhdim "Palë",

Në bazë: të Marrëveshjes së NATO (SOFA) PfP ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995;

Në bazë: të Marrëveshjes midis Qeverisë së Republikës Italiane dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë mbi Bashkëpunimin në fushën e Mbrojtjes, firmosur në Romë në datë 13 tetor 1995, ratifikuar nga Parlamenti Italian me ligjin nr.49 datë 18 shkurt 1999 dhe nga Parlamenti Shqiptar me ligjin nr.8128 datë 22 korrik 1996.

Në bazë: të dekretit ligj nr.1 të 13 janarit 1998, të Parlamentit Italian, koordinuar me ligjin nr.42, datë 13 mars 1998, "Dispozitat urgjente në fushën e bashkëpunimit midis Italisë dhe Shqipërisë në sektorin e mbrojtjes, si dhe zgjatja e qëndrimit të kontigjentëve ushtarakë italianë në Bosnjë-Hercegovinë. Zgjatja e pjesëmarrjes së vëzhguesve italianë në grupin e vëzhguesve të përkohshëm në

Hebron";

Në bazë: të Protokollit Teknik midis Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës Italiane, "Mbi përmbushjen e Marrëveshjes Ndërqeveritare për bashkëpunim në fushën e Mbrojtjes, firmosur në Romë më 28 gusht 1997;

DUKE PATUR PARASYSH: faktin, që Pala shqiptare ka kërkuar ristrukturimin e infrastrukturave logjistike dhe stërvitore të Akademisë së Forcave Ajrore në Vlorë dhe risistemimin e pistës së fluturimit prej dheu në Pishë- Poro;

DUKE KONSIDERUAR: "Deklaratën Paraprake", nënshkruar në Tiranë, më 15 qershor 2000, nga Ministrat e Mbrojtjes të të dy vendeve;

Kanë rënë dakord për sa vijon:

Neni 1

1.Kjo Marrëveshje ka për qëllim përcaktimin e detyrimeve reciproke që Palët marrin përsipër për vënien në zbatim të projekteve për ristrukturimin dhe përmirësimin e kapaciteteve logjistike të Akademisë së Forcave Ajrore në Vlorë nëpërmjet ndërhyrjeve me qëllimri kuperimin dhe riaftësimin e infrastrukturave dhe të pistës së fluturimit prej dheu të zonës aeroportuale të Pishë - Poros, të cilën Pala Shqiptare ka parashikuar për ta rivënë në përdorim për aktivitetin stërvitor të fluturimit.

2. Palët do të veprojnë së bashku, duke respektuar rregullat e brendshme juridike përkatëse dhe duke përdorur çdo formë të dobishme bashkëpunimi për një përdorim optimal të burimeve të disponueshme në kuadër të ndërhyrjeve të përcaktuara në nenin 2 e në vazhdim.

Neni 2

1. Aktiviteti i bashkëpunimit dhe asistencës midis Palëve, nëse nuk përcaktohet ndryshe nga kjo Marrëveshje, do të zhvillohet siç është përcaktuar në Protokollin e 28 gushtit 1997.

2. Pala italiane do të japë konsulencë dhe asistencë teknike si në fazën projektuese, ashtu dhe në fazën ekzekutive të punimeve, do të sigurojë furnizimin me materiale të nevojshme për kryerjen e punimeve të parashikuara dhe të përshkruara në Shtojcat "A" dhe "B" të kësaj Marrëveshjeje. Përsa i përket procedurave kontraktuale për furnizimin me materiale do të aplikohen normat e Bashkimit Europian.

3. Pala italiane do të përjashtohet nga taksat dhe detyrimet doganore që aplikohen në Shqipëri për personelin dhe materialet që do të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas Marrëveshjes NATO (SOFA) / PfP, të nevojshme për kryerjen e punimeve që kanë të bëjnë me këtë Marrëveshje dhe që do të transportohen nga Italia për në Shqipëri.

4. Pala italiane, për kryerjen e detyrave të caktuara sipas kësaj Marrëveshjeje dhe për sigurimin dhe ruajtjen brenda zonës së punimeve, të personelit, të infrastrukturave, të materialeve dhe të mjeteve të punës është e autorizuar të dërgojë dhe të vendosë në Shqipëri, në zonën e Vlorës, një njësi logjistike të Aviacionit Ushtarak Italian me elemente riparimi, mirëmbajtjeje, ruajtjeje dhe sigurimi me një personel jo më shumë se 200 trupa. Përbërja dhe detyrat e kësaj njësie logjistike janë përcaktuar në shtojcat "A", "B" dhe "C", bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje. Njësia logjistike e Aviacionit Ushtarak Italian do të jetë e pranishme në Shqipëri derisa të përfundojnë punimet sipas shtojcave "A" dhe "B",

5. Veprimtaria e njësisë logjistike në Shqipëri, do të kryhet në përputhje të plotë me dispozitat e Marrëveshjes NATO (SOFA) / PfP dhe Protokollit të saj, shtesë.

6. Pala shqiptare do të impenjohet të përgatisë projektin e punimeve dhe për ekzekutimin e tij do të caktojë Drejtorin e Punimeve, përgjegjës për zbatimin me korrektësi të punimeve dhe të rregullave të sigurisë në kantieret, duke u mbështetur në asistencën dhe konsulencën teknike të palës italiane, si dhe do të sigurojë krahun e punës, mjetet dhe mbështetjen logjistike të nevojshme.

7. Për kryerjen e punimeve, e cila është qëllimi i kësaj Marrëveshjeje, Pala shqiptare është përgjëgjëse për projektin, zbatimin dhe kolaudimin e strukturave, si dhe për përdorimin korrekt të materialeve të dhëna nga Pala italiane.

Në këtë kontekst Pala shqiptare do të jetë përgjegjëse ndaj Palëve të treta përsa i përket zgjidhjes së ndonjë pretendimi për pronësinë dhe dëmeve materiale të shkaktuara ndaj të tretëve gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Pala shqiptare, në veçanti, do të impenjohet:

a) në caktimin e projektuesit, drejtorit të punimeve dhe përgjegjësave të skuadrave që janë të aftë dhe të specializuar në këto punime;

b) të bëjë të mundshëm përdorimin e mjeteve të kantierit dhe mjeteve të transportit që ka në dispozicion, mes të cilave dhe ato që ka dhënë pala italiane, duke përfshirë drejtuesit e automjeteve dhe pjesët e këmbimit;

c) të sigurojë numrin e nevojshëm të krahut të punës, për të kryer në rregull punimet, e që do të veprojnë nën vartësi të drejtpërdrejtë dhe nën përgjegjësinë e drejtorit të punimeve;

d) të krkojë nga autoritetet kompetente autorizimet e parashikuara për të gjitha punimet që do të kryhen (lidhjet elektrike me tensione të mesëm, hidrike, kanalizimet etj).

2. Pala italiane, në veçanti, impenjohet:

a) në caktimin e konsulentëve që do të punojnë në krah të projektuesit, drejtorit të punimeve dhe përgjegjësve të skuadrave të Palës shqiptare;

të japë asistencë teknike për të gjithë mjetet që do të përdoren gjatë punimeve;

të furnizojë me materialet e ndërtimit të nevojshëm për kryerjen e punimeve.

d) të ndihmojë, me aq sa mundet, me personel të specializuar që nevojitet për kryerjen e punimeve për ristrukturimin e Akademisë së Forcave Ajrore në Vlorë.

3. Në shtojcën "D" të kësaj Marrëveshjeje përcaktohet organizimi i grupeve të punës në përgjithësi.

Për shtesa të vogla të mundshme që mund të nevojiten në sektorët e parashikuar të punimeve, do të bihet dakord nga të dy palët, duke përcaktuar herë pas here nevojat dhe disponibilitetin.

Neni 4

1.Pala shqiptare do të sigurojë:

a) hyrjen e mjeteve ushtarake italiane të transportit tokësor dhe ajror, si dhe përdorimin e infrastrukturave dhe të zonave të Akademisë së Forcave Ajrore në Vlorë si dhe të pistës së fluturimit prej dheu në Pishë - Poro, për qëllimet e përcaktuara në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje;

b) vënien në dispozicion të vendeve ku do të vendoset zona e kantierit;

c) ndihmën logjistike të plotë për personelin e vet dhe për automjetet e veta në përdorim, për përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim të asaj që parashikohet.

d) zona dhe struktura të përshtatshme në të cilat do të vendosen, magazinohen dhe ruhen të gjitha materialet, mjetet dhe veglat që do të përdoren gjatë punimeve;

e) me ndihmën e Policisë Ushtarake, sigurinë e vazhdueshme në zonat e kantierit të personelit, të infrastrukturave, të materialeve dhe të mjeteve që do të përdoren gjatë punimeve për të cilën bën fjalë kjo Marrëveshje.

2.Pala italiane do të sigurojë:

a) mbështetjen e plotë logjistike për personelin e vet;

b) ushqim për personelin e të dy palëve të punësuar në zonat e kantiereve;

c) karburantet dhe lubrifikantet për të gjitha mjetet e kantierit të përdorura nga Pala shqiptare;

d) ndihmën në mirëmbajtje dhe riparimin e mjeteve duke u kufizuar në ato të dhëna nga pala italiane me përjashtim të pjesëve të këmbimit.

Neni 5

Secila prej Palëve impenjohet, që të japë ndihmë shëndetësore të ndihmës së shpejtë të gjithë personelit të punësuar në punime. Në rast se nevojitet transport shëndetësor në spital i të lënduarve, të dyja palët do të vënë në dispozicion një autoambulancë të pajisur me të gjitha mjetet, e cila duhet të jetë vazhdimisht e pranishme në kantier për çdo urgjencë.

Neni 6

1. Mbi bazën e aktiviteteve të parashikuara në Projektin e Ristrukturimit të Akademisë së Forcave Ajrore në Vlorë, Palët mund të bien dakord për gjetjen e formave të tjera të bashkëpunimit në sektorin e stërvitjes së aviacionit. Në këtë kuadër, Palët mund të bien dakord për nisma lidhur me nisjen e programeve në shkëmbimin e personelit, si dhe për dërgimin e ekspertëve ushtarakë italianë në Akademinë e Forcave Ajrore në Vlorë me qëllim dhënien e konsulencës për aktivitetin e fluturimit dhe të mësuarit e lëndëve teknike të trajtuara, në bazë të protokollit të datës 28 gusht 1997.

2. Palët impenjohen, gjithashtu që të zhvillojnë së bashku dhe në bazë të kësaj Marrëveshjeje, një projekt për shndërrim në strukturë aeroportuale të pistës së fluturimit prej dheu në Pishë - Poro.

Neni 7

1. Personeli italian në Shqipëri do të gëzojë statusin juridik, që parashikohet nga Marrëveshja NATO (SOFA) PfP dhe nga Protokolli i saj shtesë. Kushtet e kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen mutatus mutandis, për të gjitha situatat që lidhen me statusin juridik të personelit të njësisë logjistike të Aviacionit Ushtarak Italian.

2. Gjatë qëndrimit në Shqipëri, ushtarakët italianë të njësisë logjistike të Aviacionit Ushtarak, për ruajtjen dhe sigurimin e personelit si dhe të furnizimeve materialo-teknike, në zonat e kantierit (Akademia e Forcave Ajrore dhe pista e fluturimit prej dheu në Pish-Poro), gjatë shoqërimit të mjeteve dhe të kolonave italiane në linjat e komunikimit në interes të këtyre punimeve dhe në vendakomodimet e tyre, do të veprojnë në përputhje me ligjin 8290 të datës 24 shkurt 1998 të Parlamentit Shqiptar "Për përdorimin e armëve të zjarrit", për aq sa pajtohet me sistemin juridik italian.

Neni 8

1. Punimet që lidhen me ristrukturimin e Akademisë së Forcave Ajrore në Vlorë dhe të pistës së fluturimit prej dheu në Pishë-Poro, do të përcaktohen formalisht me Marrëveshje të detajuara, të formuluara dhe pranuara me mirëkuptim midis ekspertëve të të dy Palëve.

2. Kohëzgjatja e nevojshme për kryerjen e punimeve të parashikuara dhe vlefshmëria e kësaj marrëveshjeje është 6 (gjashtë) muaj, duke filluar nga data e firmosjes, me të drejtë përsëritjeje automatikisht, me pëlqimin e Palëve, edhe për një periudhë tjetër 6 (gjashtë) mujorë, në rastet kur për shkaqe të arsyeshme nuk kanë përfunduar ende punimet.

3. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet, modifikohet ose amendohet, në çdo moment, me pëlqimin paraprak me shkrim të të dy Palëve.

4. Kjo Marrëveshje mund të ndërpritet në çdo moment nga njera ose të dy Palët duke njoftuar me shkrim 30 ditë përpara.

5.Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga një interpretim i ndryshëm i neneve të kësaj Marrëveshjeje për zbatimin e saj të mëpastajshëm, do të zgjidhen nëpërmjet bisedimeve mes të dy palëve, pa iu drejtuar një Pale të tretë.

6. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi përkohësisht në momentin kur të dyja Palët do të kenë firmosur dhe përfundimisht, kur palët do të njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore të miratimit.

Përfaqësuesit e nënshkruar, me autorizimin e duhur, për palën italiane dhe për palën shqiptare kanë firmosur përkatësisht këtë Marrëveshje në Tiranë, më 4.6.2001 dhe në Romë, më 7.5.2001, në dy origjinale, në gjuhën shqipe dhe italiane, ku secili tekst është i barazvlefshëm me njëri-tjetrin.

SHTOJCA "A"
NDËRHYRJET E PROGRAMUARA PËR ZONËN LOGJISTIKE TË AKADEMISË SË FORCAVE AJRORE

1. Punimet kanë për qëllim ristrukturimin e ndërtesave të treguara në planimetrinë Aneksi 1, të shënuara me numrat nga 1, 3, 4, 5, 6, 7.

2. Punimet do të tregohen të detajuara në projektin final të përpunuar nga pala shqiptare bashkë me palën italiane. Në veçanti bëhet fjalë për:

- kryerjen e punimeve për ringritjen e mbulesës, aty ku është e nevojshme, zëvendësimin

dhe/ose ristrukturimin e ullukeve;

- realizimin e grupeve të banjove dhe dusheve, aty ku është e nevojshme të pajisur me të gjithë impiantin e nevojshëm hidrik me ujë të ngrohtë dhe të ftohtë dhe sharkimin e ujrave të zeza deri në pusetën jashtë ndërtesës;
- riparimin, ku është i nevojshëm, të mureve, çative, suvatimeve, dyshemeve, lyerjes me bojë jashtë dhe brenda;
- realizimi i impiantit elektrik sipas kushteve teknike, me plato ndriçimi prej neoni.

3. Infrastruktura e paraqitur me nr.8 i referohet një parafabrikati betoni, i cili do të ketë në përbërje komponentët tashmë të projektuara dhe të montuara nga një ndërmarrje për një central elektrik MT/BT-6000 V/380 - me fuqi rreth 300 KVA, që do të ushqehet nga një kavo elektrike nëntokësore nga shtylla MT më e afërt.

4. Secila nga ndërtesat duhet të jetë e kompletuar me:


- energji elektrike, të instaluar në tuba me kavo, që vjen nga centrali ndërtesa nr.8 deri tek kuadrot e vendosur në hyrjen e çdo ndërtese;
- realizimin e rrjetit hidrik dhe të depos së ujit me sistem autoklavë me anë të lidhjes me rrjetin hidrik të qytetit që është brenda Akademisë së Forcave Ajrore në Vlorë;
- kanalizimet e ujërave të zeza deri tek kanalizimet e qytetit nëpërmjet tubacionit në PVC të rëndë dhe pusetat e nevojshme shpërndarëse dhe të kontrolleve.

5. Gardhi metalik mbi perimetrin e treguar nga pala shqiptare do të realizohet sipas standardit italian.

Aneksi i Shtojcës “A”

PLANIMETRI E ZONËS LOGJISTIKE

(pashtë shkallës)



SHTOJCA "B"

NDËRHYRJET E PROGRAMUARA NË ZONËN OPERATIVE TË PISHË-PORO-S

1. Ndërtimi i një gardhi rrethues përgjatë perimetrit të zonës në fjalë, nivelimi paraprak i terrenit me mjetet mekanike dhe pastrimi i kanalit kullues.

Parashikohet realizimi i një mbikalimi në kanalin kullues dhe i një porte me kangjella metalike, në korrespondencë me hyrjen e bazës në veri dhe me hyrjen në lindje të zonës aeroportuale.

2. Përgatitja e rrugës perimetrore, nëpërmjet nivelimit dhe ngjeshjes. Sjellja e materialeve për shtresën fundore të rrugës, në pjesën e rrugës perimetrore, që nga hyrja lindet me hyrjen në veri dhe me vendkomandën e kullën e kontrollit.

3. Vendosja e karër parafabrikateve për banim dhe një parafabrikati për nevoja higjenike, të cilat do të përbëjnë godinat për personelin e rojës, katër parafabrikateve për banim dhe një parafabrikati për nevoja higjenike për komandën, si dhe dy parafabrikateve për banim sipër njëra - tjetrës për kullën e kontrollit. Të gjitha këto parafabrikate duhet të jenë të pajisura dhe të furnizuara me energji elektrike, ujë dhe shkarkimet e ujrave të zeza.

4. Përgatitja, nëpërmjet nivelimit dhe ngjeshjes së pistës së fluturimit prej dheut të parashikuar për nevojat lidhur me fluturimin e mjeteve fluturuese stërvitore.

5. Vendosja e një gypi ajrimi aeroportual dhe mjeteve të shërbimit sinoptik në afërsi të kullës së kontrollit.

SHTOJCA "C"
PËRBËRJA DHE DETYRAT E NJËSISË LOGJISTIKE TË AVIACIONIT USHTARAK ITALIAN

1. Njësia Logjistike e Aviacionit Ushtarak Italian përbëhet nga:

- Një komponent komande e përbërë nga minimumi 22 veta deri në maksimumi 25 veta, me detyra komande dhe bashkërendimi;
- një komponent asistence teknike për projektimin, kryerjen dhe kolaudimin e punimeve e përbërë nga minimumi 21 veta deri në maksimumi 46 veta me detyrë dhënien e ndihmës së specializuar dhe asistencës teknike Palës shqiptare;
- një komponent për mbështetje logjistike e përbërë nga minimumi 57 veta deri në maksimumi 78 veta me detyrë dhëniej e mbështetjes logjistike njësisë dhe mbështetjen për kryerjen e punimeve të ristrukturimit të infrastrukturave në Akademinë e Forcave Ajrore në Vlorë, si dhe të pistës së fluturimit prej dheu në Pishë-Poro;
- një komponent ruajtje dhe sigurimi i përbërë nga minimumi 48 veta deri në maksimumi 51 veta për sigurinë e personelit italian dhe ruajtjen e mjeteve dhe materialeve.

2. Përbërësit e njësisë logjistike janë të autorizuar të veshin uniformën italiane dhe gjatë kryerjes së shërbimit të tyre të mbajnë armatim individual, siç është paraqitur nga Marrëveshja NATO (SOFA) PfP.

SHTOJCË "D"
GRUPET E PARASHIKUARA TË PUNËS

1. Për kryerjen e punimeve të parashikuara konsiderohet e domosdoshme ngritja e nr.3 grupe pune, aktivizimi i të cilave do të nisë sipas nevojës në momentin e duhur të zhvillimit të punimeve, siç tregohet më poshtë:

a) grupi i punës në Pishë-Poro;

b) grupi i punës në Akademinë e Forcave Ajrore për ristrukturimin e brendshëm të ndërtesave;

c) grupi i punës në Akademinë e Forcave Ajrore për punimet nga jashtë ndërtesave.

2. Çdo grup duhet të ketë në përbërje praninë konstante të dy asistentëve ekspertë për punimet në kryerje e sipër, njëri italian dhe tjetri shqiptar.

3. Numri i grupeve mund të ndryshohet me pëlqimin e palëve gjatë kryerjes së punimeve.